

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6959
E enjte, 3 gusht 2023
Çmimi 0.40

KQZ-ja e gatshme
për zgjedhje të reja
në veri | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (KDI) KA PUBLIKUAR RAPORTIN
E MONITORIMIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOSOVËS | FAQE 4-5

KUVENDI, PARAQITJE TË DOBËT NË SESIONIN PRANVEROR

- KDI-ja: Deputetët ishin të kujdesshëm për mëditje,
të përgjegjshëm për të marrë pjesë në seanca



Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka bërë bilancin e punës së Kuvendit të Kosovës për sesionin pranveror. KDI-ja ka bërë me dije se gjatë këtij sesiioni Kuvendi ka

përbushur vetëm 13 për qind të planit legjislativ. Sipas KDI-së, gjatë këtij sesiioni Kuvendi ka miratuar 44 projektligje, kurse 11 prej tyre kanë qenë marrëveshje

ndërkombëtare. KDI-ja ka vlerësuar se deputetët kanë qenë të kujdesshëm për mëditje, por të papërgjegjshëm për të marrë pjesë në seanca

AKTUALE



KFOR-i, POLICIA DHE EULEX-i
DISKUTOJNË PËR MASAT
E SHTENSIONIMIT TË SITUATËS
NË VERI | F. 3

KMDLNJ: LIGJI I RI PËR SKEMAT
PENSIONALE, AMBALAZHIMIN E KA
MASHTRUES | F. 7

MBINGARKOHET KLINIKA E
PEDIATRISË NË QKUK | F. 6

KOMUNA E MITROVICËS SHPËRNDAN
85 MOTOKULTIVATORË PËR FERMERËT
F. 6

EKONOMI



GRURË SIVJET, PAK E ME CILËSI
TË DOBËT | F. 8

VETËVENDOSJA: KOSOVA
ME NORMËN MË TË ULËT
TË INFLACIONIT NË RAJON | F. 8

SPORT



TRAJNERI DURO DHE
SHTATË FUTBOLLISTË LARGOHN
NGA GJILANI | F. 10

'RINIA
LARGOHE, ROZETA
PASUROHE',
TË RINJTË E
PDK-SË KËRKOJNË
DORËHEQJEN
E MINISTRES
HAJDARI | FAQE 5



SHTOHN LËNDËT CIVILE TË
PAZGJIDHURA NË GJYKATA
FAQE 5



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Erdogani i bën thirrje Putinit të mos i përshkallëzojë tensionet në Ukrainë

ANKARA, 2 GUSHT - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, i ka bërë thirrje homologut të vet rus, Vladimir Putin, të mërkurën, të mos i përshkallëzojë më shumë tensionet, pasi Moskë i ka sulmuar me dronë objektet jetike për eksportimin e drithërave nga Ukraina.

Erdogani ka luajtur rol kyç në ndërmjetësimin e marrëveshjes tashmë të prishur për eksportimin e sigurt të drithërave ukrainase përmes Detit të Zi dhe e ka pozicionuar veten si ndërmjetësues në konflikt.

Lideri turk ka thënë se “nuk duhet të merret asnjë hap i cili do t'i përshkallëzonte tensionet në luftën Rusi - Ukrainë”. Ai ka

nënvizuar rëndësinë e marrëveshjes së drithërave, të cilën e ka quajtur “ura për paqe”, është thënë në një komunikatë për media të Presidencës turke. Marrëveshja kishte për qëllim ta zbutte krizën globale të ushqimit duke i lejuar drithërat ukrainase të eksportoreshin në mënyrë të sigurt.

Ujdia, e ndërmjetësuar nga Turqia dhe Kombet e Bashkuara, ia mundësonte Ukrainës të eksportoje drithëra përmes porteve të saj në Detin e Zi, por përfundoi muajin e kaluar kur Moskë i tërhoq nga ajo.

Sulmet ruse me dronë i kanë dëmtuar objektet e drithërave në portet e Ukrainës, Odesa dhe



Izmail, gjatë natës, thanë autoritetet ukrainase më 2 gusht. Si pasojë e sulmeve ruse, një depo drithi, silose drithi dhe

magazina të tjera drithi u dëmtuan apo shkatërruan, thanë prokurorët ukrainas. Erdogani i ka thënë Putinit se

pasiviteti afatgjatë i marrëveshjes së drithërave “nuk do t'i bëjë dobi askujt”, dhe se vendet në nevojë do të vuanin më së shumti, sipas Presidencës turke. Erdogani tha, gjithashtu, se çmimet e drithërave që ranë për 23 për qind sa ishte në fuqi marrëveshja, u rritën për 15 për qind gjatë dy javëve të fundit. Ai është zotuar se Turqia do t'i vazhdojë me këmbëngulje “përpjekjet intensive” dhe diplomatike për ta kthyer në fuqi marrëveshjen.

Dy liderët janë pajtuar për një vizitë të Putinit në Turqi, sipas zyrës së Erdoganit, e cila nuk ka treguar ndonjë datë të caktuar, megjithatë.

ShBA-ja thotë se ka sinjale se Rusia do të rikthehet në bisedimet për marrëveshjen për drithërat



WASHINGTON, 2 GUSHT - Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) u është thënë se Rusia është e gatshme të kthehet në bisedimet për marrëveshjen që lejon eksportimin e sigurt të drithërave ukrainase nga Deti i Zi. Por, “ne ende nuk kemi parë ndonjë dëshmi për këtë”, ka thënë e dërguara e ShBA-së në Kombet e Bashkuara. Rusia është tërhequr nga marrëveshja për drithërat më 17 korrik. Ambasadorja e ShBA-së në OKB ka thënë se nëse Rusia dëshiron që plehrat e saj artificiale të

arrijnë në tregjet botërore dhe të ketë lehtësim në transaksionet për produktet bujqësore “ata duhet të kthehen në këtë marrëveshje”. “Ne kemi parë tregues se ata mund të jenë të interesuar që të rikthehen në diskutime. Prandaj, ne duhet të presim që të shohim nëse kjo do të ndodhë”, ka thënë ajo pa dhënë më shumë detaje. Tërheqja e Rusisë nga marrëveshja ka pamundësuar që Ukraina – një prodhuese globale e drithërave – të eksportoje në mënyrë të sigurt

prodhimet bujqësore nga portet në Detin e Zi tekta pushtimi rus i Ukrainës po vazhdon.

Vitin e kaluar, pas nisjes së pushtimit të Ukrainës, OKB-ja dhe Turqia ndërmjetësuan marrëveshjen për eksportin e drithërave. Që nga tërheqja e Rusisë nga marrëveshja, Ukraina po eksporton produktet e saj përmes rrugëve tokësore për në Bashkimin Evropian, por edhe përmes rrugëve alternative përmes lumit Danub.

Bloku i shteteve të Afrikës Perëndimore: Ndërhyrja ushtarake në Niger, mjet i fundit

ABUJA, 2 GUSHT - Bloku rajonal i shteteve të Afrikës Perëndimore ka thënë se ndërhyrja ushtarake në Nigeri që po udhëhiqet nga junta “është mjet i fundit”, përderisa Nigeria ka ndërprerë furnizimet elektrike për ta shtuar presionin ndaj liderëve të puçit. Shefat e ushtrisë të shteteve të këtij blloku janë takuar më 2 gusht për të përgatitur një përgjigje për situatën në Niger. Në takim ishte i pranishëm edhe një delegacion nga Nigeri, një javë pas puçit ushtarak, që detyroi Francën t'i evakuonte shtetasit e saj.

Bashkësia Ekonomike e Shteteve të Afrikës Perëndimore (ECOWAS) gjatë fundjavës ka vendosur sanksione tregtare dhe financiare dhe u dha afat prej një jave puçistëve që ta rikthejnë pushtetin të presidenti i zgjedhur

në mënyrë demokratike ose kanë paralajmëruar se ata do të përballen me përdorimin e forcës.

“Opsioni ushtarak është mjeti i fundit, por ne jemi të përgatitur për çdo mundësi”, ka thënë Abdel-Fatau Musah, komisionar për politikë të jashtme, paqe dhe siguri në ECOWAS.

Musah ka thënë se një ekip i ECOWAS, i udhëhequr nga ish-lideri nigerian Abdulsalami Abubakar, ka qenë në Niger për “negociata”.

ECOWAS do të zhvillojë takim treditor në Abuxha. Aktualisht këtë grup rajonal e udhëheq Nigeria, që është superfuqi ushtarak dhe ekonomike në Afrikën perëndimore. Ky shtet veçse ka ndërprerë furnizimet me energji elektrike për Nigerin. Nigeri, një prej shteteve më të



varfra në botë, merr 70 për qind të energjisë elektrike nga Nigeria. Ndërsa Mali dhe Burkina Faso, që udhëhiqen nga juntat ushtarake, kanë paralajmëruar kundër çdo ndërhyrjeje ushtarake në Niger, duke konsideruar se një gjë e tillë do të ishte “shpallje e luftës”

kundër tyre.

Një prej liderëve të puçit, gjenerali Salifou Mody, ka shkuar në Mali për negociata. Por, më shumë detaje nuk janë bërë të ditura për këtë vizitë.

Presidenti i Nigerit, Mohamed Bazoum, është rrëzuar nga

pushteti gjatë puçit ushtarak më 26 korrik. Ai ishte zgjedhur president më 2021, në zgjedhjet e para në këtë shtet ku ndodhi dorëzim paqësor i pushtetit. Për shkak të puçit, Franca ka njoftuar se do t'i vazhdojë evakuimet e shtetasve të saj nga Nigeri. Deri më tani nga ky shtet janë larguar 500 persona, shumica francezë. Por, në mesin e të evakuuarve ka edhe shtetas të Portugalisë, Belgjikës, Nigerisë, Etiopisë dhe Libanit. Edhe Italia ka njoftuar se ka evakuuar rreth 100 të huaj nga Nigeri, dhe radio ANSA raportoi se në mesin e tyre ishin 36 italianë dhe 21 amerikanë. Kurse Gjermania u ka bërë thirrje shtetasve të saj të largohen. Shtetet e Bashkuara – që kanë 1 100 trupa të stacionuara në Niger – deri më tani nuk kanë bërë ndonjë njoftim për evakuimin e amerikanëve.

“Rinia largohet, Rozeta pasurohet”, të rinjtë e PDK-së kërkojnë dorëheqjen e ministres Hajdari

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Rinia Demokratike e Kosovës (RDK) ka organizuar të mërkurën një aksion simbolik para Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) për zhvillimet e fundit të cilat e lidhin këtë ministri për keqpërdorimin e qindra mijëra eurove të rezervave shtetërore të vajit, sheqerit dhe grurit. “Vaji dhe Polonia, si Rozeta e hajnia”, “Rinia largohet, Rozeta pasurohet” dhe “Ju me zemër, na pa bukë!”, kanë qenë disa nga parullat e aksionit të RDK-së. Kryetarja e Rinisë Demokratike të Kosovës, Arbnora Salihu, ka thënë se MINT-i në krye me ministren Rozeta Hajdari deri tani ka shpërfaqur vetëm keqmenaxhim e abuzim të parasë publike. “Përgjimet që lidhen specifikisht me vajin dhe sheqerin dëshmojnë se kjo ministri ka blerë vaj dhe sheqer me vlerë mbi 300 mijë euro prej një kompanie polake. Paratë i kanë dhënë, por vaji, sheqeri e gruri nuk janë askund. Ne po e zhvillojmë këtë aksion simbolik, sepse kjo ministri në krye me Rozetën nuk ka treguar rezultat deri më tani, por vetëm keqmenaxhim e abuzim të parasë publike”, ka thënë Salihu. Me këtë rast, ajo ka kërkuar dorëheqjen e menjëhershme të

Rozeta Hajdarit, si dhe u ka bërë thirrje organeve të rendit t'i hetojnë këto skandale korruptive. “Po shihet qartë që qeveria Kurti me skandalet e saj të njëpasnjëshme nuk e ka prioritetin rininë. Andaj, ne kërkojmë dorëheqjen e menjëhershme të Rozeta Hajdarit dhe kërkojmë nga organet e rendit t'i hetojnë këto skandale korruptive”, ka thënë Salihu.

Para se të mbahej ky aksion simbolik i të rinjve të PDK-së, gazeta “Nacionale” ka publikuar disa incizime të reja në Ministrinë e Tregtisë së drejtuar nga Rozeta Hajdari. Kësaj radhe tema është e njëjtë, për blerjen e mallrave në rezervën shtetërore. Ndryshon vetëm produkti. Nga vaji, tash është afera “Gruri”.

Zyrtarë të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në këto incizime bisedojnë rreth nënshkrimit të kontratës për blerjen e grurit vitin e kaluar. Ata përmendin me emra disa zyrtarë si Hafiz Gara, Rexha, Arbëri, këshilltari (që nuk dihet nëse është fjala për këshilltarin e ministres, apo të ndonjë zyrtari tjetër).

Krejt përgjimi tregon për zyrtarin Enver Hajrullahu që me pozitë është certifikues. Ndaj tij kishte presione të mëdha për ta nënshkruar kontratën rreth



grurit, edhe pse disa tonë mungonin. Certifikuesi nuk pranonte ta nënshkruante. Sipas bisedës, kuptohet se kishte dyshime që një sasi e grurit në sasi prej 9 tonë grurë po mungonte. Kjo duket se kishte shkaktuar edhe përplasje ndërmjet disa zyrtarëve në ministrinë e Rozeta Hajdarit. “Unë i kam thanë nuk e paguaj për qetë punë për qetë punë, se tash ky shpediteri, ky që e ka pas (nuk kuptohet), e ka pasur edhe shpedicionin. Ai thojke e kam prur, shpediteri thojke mungojnë 9 tonë. Këta thojshin mungojnë pak ma shumë, se aty në kontratë

thuhet se duhet me i sjellë 10 mijë tonë. Me nen nuk duhet me humb asnjë pike rrugës”, dëgjohej teksa flet një zyrtar i Ministrisë së Tregtisë e Industrisë. Kjo kishte shkaktuar tension në MINT. Madje zyrtarët që bisedojnë bëjnë me dije se kishte pasur rrezik edhe për një përplasje fizike ndërmjet Hafizit dhe ministres Hajdari. Zyrtarët e konfirmojnë se disa nga veprimet kanë qenë të jashtëligjshme. “Fol ti drejtor që vë vendime të jashtëligjshme”, dëgjohej teksa flet një zyrtar i Ministrisë me një tjetër. “Edhe tani hiq, para dy tri jave një muaji, fytas e kemi qu me

ministren, ma Hafizi ke tu e rre”, thuhet në bisedë.

Gjatë bisedave përmendet edhe drejtori i Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. Zyrtarët tregojnë se kanë qenë në mëdyshje nëse duhet të bëhet kjo pagesë apo jo. “Lem thash me folë. I nderuar drejtor kemi tha qeshtu (nuk kuptohet...) Jo tha normal duhet me u ba ajo pagesë drejtor, certifikuesi po ndërhyj po ta shpjegoj ma gjerësisht (nuk kuptohet) E u ndal ajo, plus drejtori i AKI-së po shkruan drejtpërdrejt (nuk kuptohet) – Edhe po i thotë, veç pak ministre për këtë punë qysh pe shpjegon certifikuesi jo që jeni duke i ba presion, por duhet me vlerësu punën e tij”, është thënë në bisedën e siguruar nga “Nacionale”.

Ndaj këtij përgjimi kanë reaguar përfaqësuesit e partive opozitare, të cilët e kanë akuzuar pushtetin për hajni. Po ashtu, ka reaguar edhe Enver Hajrullahu, protagonist i bisedave të reja në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Ai ka thënë se bisedat e publikuara nuk kanë rrjedhur prej tij edhe pse ato incizime janë bërë në hapësirat e MINT-it përkatësisht, sipas tij, në njërin nga zyrat e Departamentit të Financave.

KQZ-ja e gatshme për zgjedhje të reja në veri

PRISHTINË, 2 GUSHT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) do t'i organizojë sërish zgjedhjet në katër komunat veriore të vendit kurdo që i kërkohen nga institucionet përgjegjëse. Kështu ka thënë zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi. Sipas tij, KQZ-ja si institucion i përhershëm kushtetues e ka për detyrë kryesore organizimin e zgjedhjeve kurdo që ato shpallen, “prandaj edhe do të merret me të gjitha fazat e organizimit e implementimit të planit”. Elezi ka shtruar se me këtë ata po përbushin detyrat që dalin nga Kushtetuta e ligjet në fuqi. “Komisioni Qendror i

Zgjedhjeve, si institucion i përhershëm kushtetues, e ka për detyrë kryesore organizimin e zgjedhjeve kurdo që ato shpallen. Si çdoherë, ashtu siç kemi thënë edhe në të kaluarën, KQZ-ja është e gatshme për t'i përbushur detyrat që dalin nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi”, ka thënë Elezi.

Ndërsa Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka filluar procedurat për largimin e katër kryetarëve në komunat në veri. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka dhënë detaje në lidhje me procedurat për largimin e katër kryetarëve në komunat në veri. Ai ka sqaruar se grupi punues i



themeluar duhet ta finalizojë Projekt-Udhëzimin Administrativ dhe ta procedojë deri më 1 shtator të këtij viti, duke pohuar se kjo do të vlejë për gjithë vendin e jo vetëm për veriun. Ai ka sqaruar se ndonëse kishin nisur ndryshimet e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kjo nuk është mundur për shkak se duheshin 2/3 e votave të

deputetëve të komuniteteve.

Krasniqi nga Lipjani ka thënë se dorëheqja e kryetarëve në veri nuk mund të kërkohet, por se duhet të vendoset me mekanizma ligjorë, siç është në këtë rast peticioni. “Grupi ka afat një muaj që ta bëjë draftin dhe mandej të jetë nga 1 shtatori udhëzimi. Mirëpo çka është e rëndësishme është se ky udhëzim që buron nga ligji nuk vlen vetëm në veri. Mund të shfrytëzohet nga të gjitha komunat. Unë jam shumë i bindur që do të jetë profesional. Kryetarët në veri kanë fituar mandat. Dorëheqja nuk mund të kërkohet nga asnjë institucion tjetër përveçse me peticion nga

qytetarët”, ka thënë ai.

Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal ka formuar grupin punues për hartimin e udhëzimit administrativ i cili do të mundësonte largimin e kryetarëve të komunave në veri përmes peticionit të qytetarëve. Më 10 korrik Kosova ka arritur marrëveshje me BE-në për ulje të tensioneve dhe në të është përfshirë edhe mbajtja e zgjedhjeve të reja në veri. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se zgjedhje nuk mund të ketë pa shtensionim të plotë të situatës në veri. BE-ja ka bërë thirrje që zgjedhjet në veri të mbahen në një afat sa më të shkurtër kohor.

KFOR-i, policia dhe EULEX-i diskutojnë për masat e shtensionimit të situatës në veri

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Drejtuesit e Policisë së Kosovës, KFOR-it dhe EULEX-it, kanë diskutuar për masat e shtensionimit të situatës në veri të vendit. Për takimin në mes të titullarëve të fushës së sigurisë ka njoftuar Zyra për Medie e Policisë së Kosovës. “Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, me bashkëpunëtorë, priti në takim komandantin e KFOR-it, majorgjeneral Angelo Michele Ristuccia, shefin e EULEX-it në Kosovë, Giovanni Pietro Barbano dhe përfaqësues të Zyrës së BE-së në Kosovë,

lidhur me vlerësimin e situatës së sigurisë në Republikën e Kosovës, përfshirë vlerësimin e situatës në veri të vendit.

Ky ishte një takim i zhvilluar në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm që mban Policia e Kosovës me KFOR-in dhe EULEX-in. Çështjet të cilat u diskutuan kishin të bëjnë me situatën e sigurisë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe zhvillimet e fundit në veri të vendit. Në takim u vlerësua me interes të përbashkët bashkëpunimi në kuadër të detyrave dhe përgjegjësisë

përkatëse, me qëllim të ofrimit të sigurisë dhe ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike, si qëllim i përbashkët”, ka njoftuar policia. Po ashtu, shefi i EULEX-it, Giovanni Pietro Barbano, është takuar vetëm me drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, me të cilin ka diskutuar për çështje të sigurisë në vend. Barbano ka shkruar në “Twitter” se EULEX-i do të mbajë takime teknike vijuese me Policinë e Kosovës për të kryer vlerësime të përbashkëta dyjavore të sigurisë ndërmjet Policisë së Kosovës dhe EULEX-it dhe sipas nevojës



me KFOR-in. “Ne ramë dakord për modalitetet e përgjithshme për ta forcuar bashkëpunimin tonë të vazhdueshëm për ta

mbështetur stabilitetin në Kosovë dhe sigurinë e të gjitha komuniteteve të saj”, ka shkruar shefi i EULEX-it.



INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (KDI) KA PUBLIKUAR RAPORTIN E MONITORIMIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOSOVËS

Kuvendi, paraqitje të dobët në sesionin pranveror

- KDI-ja: Deputetët ishin të kujdesshëm për mëditje, të papërgjegjshëm për të marrë pjesë në seanca

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka bërë bilancin e punës së Kuvendit të Kosovës për sesionin pranveror. KDI-ja ka bërë me dije se gjatë këtij sesioni Kuvendi ka përmbushur vetëm 13 për qind të planit legjislativ. Sipas KDI-së, gjatë këtij sesioni Kuvendi ka miratuar 44 projektligje, kurse 11 prej tyre kanë qenë marrëveshje ndërkombëtare. KDI-ja ka vlerësuar se deputetët kanë qenë të kujdesshëm për mëditje, por të papërgjegjshëm për të marrë pjesë në seanca

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 GUSHT - Kuvendi i Kosovës ka përmbushur vetëm 13 për qind të planit legjislativ për vitin 2023, ka vlerësuar Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), organizatë kjo që bën monitorimin e punës së Kuvendit. Në publikimin e raportit "Ligjvënia mes shumë sfidave" është thënë se ky sesion është karakterizuar nga shumë të papritura dhe përmbajtje të llojllojshme, dhe ligjvënia gjatë kësaj periudhe është shoqëruar me shumë sfida.

Arbër Thaçi, hulumtues në KDI, gjatë interpretimit të të dhënave, ka thënë gjatë këtij sesioni Kuvendi ka zhvilluar 49 seanca në tërësi. "Gjysma e tyre ishin seanca plenare, ndërsa ngecja në trajtimin e agjendës parlamentare në vitin paraprak dhe aktual, së bashku me keqplanifikimin, shkaktoi nevojën për të zhvilluar një numër të madh të vazhdimëve të seancave. Përveç këtyre, u mbajtën edhe tetë seanca të jashtëzakonshme dhe dy seanca

të karakterit solemn", ka thënë ai. Më tutje, Thaçi ka thënë se Kuvendi gjatë kësaj periudhe ka miratuar gjithsej 44 projektligje, 11 prej të cilave ishin marrëveshje ndërkombëtare. "Nga këto, 17 projektligje ishin pjesë e planit legjislativ të qeverisë për vitin 2023, ndërsa pjesa më e madhe e projektligjeve të miratuara, 27 projektligje, ishin të planit legjislativ të viteve paraprake 2022 dhe 2021. Kështu, Kuvendi përmbushi 13 për qind të planit legjislativ 2023. Në anën tjetër, 14 projektligje ende presin miratimin në lexim të dytë, pasi janë miratuar vetëm në shqyrtim të parë gjatë këtij sesioni", ka thënë ai.

Thaçi ka treguar se mungesa e kuorumit ka ndikuar negativisht në këtë sesion, megjithatë numri i mjaftueshëm i deputetëve për t'i zhvilluar punimet e Kuvendit ka ekzistuar gjatë gjithë kohës, siç evidentohet në listat zyrtare. "Kjo dëshmon se deputetët kanë qenë të kujdesshëm për t'u regjistruar për të marrë mëditje, por kanë treguar papërgjegjshmëri në

pjesëmarrje të rregullt në punimet e Kuvendit. Kjo është në kundërshtim me aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese dhe interesin publik, që i obligon deputetët të marrin pjesë rregullisht në punimet e Kuvendit", ka thënë Thaçi. Më tutje, Thaçi ka vënë në dukje edhe përdorimin e shpeshtë të gjuhës joparlamentare, që nuk u ndëshkua nga ana e kryetarit të Kuvendit e që prodhoi tensionim të gjendjes, e cila gjatë muajit korrik eskaloj në përplasje fizike në mes të deputetëve e ministrave, me përmasa të tilla të papara ndonjëherë në Kuvend. Në anën tjetër, hulumtuesja Violeta Haxholli ka paraqitur të dhënat lidhur me funksionin mbikëqyrës të Kuvendit. Sipas saj, në këtë sesion deputetët parashtruan gjithsej 171 pyetje parlamentare. Megjithatë, numri i pyetjeve nuk ishte i kënaqshëm, duke pasur një mesatare të ulët për secilin deputet, ndërsa 82 deputetë nuk parashtruan asnjë pyetje parlamentare. Më së shumti pyetje kanë

parashtruar deputetët e partisë në pushtet me gjithsej 102 pyetje, pasuar nga partitë opozitare, PDK-ja me gjithsej 45 pyetje, AAK-ja me 13 pyetje, LDK-ja me 10 pyetje dhe komunitetet me vetëm 1 pyetje. Kryeministri Albin Kurti ka pranuar 17 pyetje kryesisht lidhur me zhvillimet në veri dhe dialogun me Serbinë për të cilat ka dhënë përgjigje. Në anën tjetër, disa nga ministrat nuk i kanë trajtuar seriozisht pyetjet e deputetëve, veçanërisht ministri i Punëve të Brendshme dhe ministrja e Punëve të Jashtme nuk u janë përgjigjur pyetjeve, ndonëse ato ishin përsëritur disa herë.

Haxholli ka folur edhe për trajtimin e reformës në drejtësi nga Kuvendi, duke vlerësuar pozitivisht konsensusin në mes të partive politike për shqyrtimin e vetingut, por duke treguar nevojën për ta mirëmbajtur konsensusin dhe zgjeruar përkrahjen për këtë proces edhe te partitë e komuniteteve joshumicë, pasi që për miratimin e amendamenteve kushtetuese për vetingun nevojiten edhe 2/3 e tyre. Sa iu përket zhvillimeve në komisionet parlamentare ato kanë mbajtur gjithsej 221 mbledhje, 10 dëgjime publike dhe 5 vizita në terren. Më së shumti mbledhje, mbi 20, kanë mbajtur Komisioni për Ekonomi, Komisioni për

Shëndetësi, Komisioni për Buxhet dhe Komisioni për Legjislacion. Komisionet kanë trajtuar rreth 35 projektligje. Ndërsa në aspektin e mbikëqyrjes ministrat e qeverisë kanë paraqitur projektligje dhe kanë raportuar 35 herë para komisioneve, ndërsa përfaqësuesit e tjerë të lartë institucionalë 42 herë. Vetëm tri komisione kanë zhvilluar vizita në terren tek institucionet përkatëse gjatë kësaj periudhe. Sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, Haxholli ka vlerësuar se vetëm dy ligje u mbikëqyrën në tërësi nga Kuvendi, një shifër që nuk është e mjaftueshme. Gjithashtu, ajo ka shprehur shqetësimin e saj lidhur me mungesën e transparencës së Kuvendit ndaj publikut, përfshirë mungesën e votimit elektronik, mospublikimin e votave me dorë dhe mospublikimin e rregullt të procesverbaleve të mbledhjeve të komisioneve parlamentare dhe atyre ad-hoc.

Në fund, KDI-ja ka ofruar disa rekomandime për Kuvendin dhe deputetët, duke theksuar nevojën për planifikim të mirëfilltë të seancave, pjesëmarrje të rregullt të deputetëve në punimet e Kuvendit, zgjerim të konsensusit dhe gjithpërfshirje për reformën në drejtësi, rritje të mbikëqyrjes ndaj ekzekutivit, adresim të gjuhës joparlamentare dhe garantim të transparencës së Kuvendit ndaj publikut.

Këshilltarja e Kurtit, Elizabeth Gowing, jep dorëheqje nga Zyra për Komunitete

PRISHTINË, 2 GUSHT - Elizabeth Katherine Gowing ka dhënë dorëheqje nga puna në Zyrën për Çështje të Komuniteteve e cila funksionon në kuadër të kabinetit të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti. Megjithatë, ajo do të vazhdojë ta ushtrijë detyrën e këshilltares politike për çështjet e komuniteteve.

Teksa ka njoftuar për këtë vendim, Katherine Gowing ka thënë se i vjen keq që në rrethanat aktuale nuk ma mundur të sigurojë që paratë publike po shkojnë aty ku duhet. "Jam krenare që vazhdoj si këshilltare e kryeministrit për çështjet e komuniteteve, me koordinimin e punës jetike për komunitetet e Kosovës, ruajtjen e kushtetutës së Kosovës si një demokraci moderne funksionale dhe sigurimin që paratë publike shkojnë aty ku duhet. Më vjen keq që në rrethanat aktuale nuk ndjeva se mund ta ruaj

integritetin dhe të vazhdoj të punoj në Zyrën për Çështje të Komuniteteve", ka shkruar ajo në "Facebook".

Ditë më parë Ministria për Komunitete dhe Kthim ka publikuar listën finale të organizatave joqeveritare të cilat kanë përfituar mbështetje financiare përmes disa projekteve që kanë për qëllim rritjen e nivelit të punësimit të anëtarëve të komunitetit joshumicë dhe përmirësimin e kapaciteteve për ta promovuar mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve.

Janë gjithsej 57 OJQ që kanë përfituar nga thirrja publike ndërkaq, sipas ministrisë, vendimi i Komisionit është i bazuar në rregulloren mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Megjithatë, një numër i madh i organizatave të cilat nuk kanë përfituar mbështetje nga kjo thirrje publike kanë bërë ankesë në



komisionin vlerësues të projektit. Ky i fundit, pas shqyrtimit të ankesave, ka nxjerrë vendim për refuzimin e tyre duke dhënë edhe

arsyetimet, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të ministrisë. E një anëtar i Komisionit Vlerësues në kushte anonimiteti i ka thënë

"Telegrafit" se në procesin e kontrollit të aplikimeve kanë ndodhur një sërë vendimesh të kundërligjshme.

Shtohen lëndët civile të pazgjidhura në gjykata

PRISHTINË, 2 GUSHT - Numri i lëndëve të pazgjidhura në fushën civile nëpër gjykatat e vendit është dyfishuar në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021. Kjo e dhënë ka dalë nga raporti "Drejtësia civile 2022" të cilin e ka hartuar Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD).

Aurela Mërlaku, hulumtuese në IKD, ka deklaruar se përderisa në vitin 2021 kanë qenë gjithsej 85 087 lëndë të pazgjidhura të cilat janë bartur në vitin pasues, viti 2022 ka shënuar rekord të ngritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti, me 99 407 lëndë të pazgjidhura.

Ajo ka thënë se arsyeja kryesore për rritjen e numrit të lëndëve të pazgjidhura ka qenë ngritja eksponenciale e numrit të lëndëve të pranuar, ku në vitin 2022 janë pranuar 40 826 lëndë, por edhe mosefikasiteti i gjykatësve. "Numri i gjykatësve për të trajtuar lëndë kontestimore gjatë vitit 2022 ka qenë 107, ndërsa numri i lëndëve të zgjidhura ka qenë 25 632. Kjo i bie se secili gjykatës në mesatare brenda një viti ka zgjidhur 239.5 lëndë përkundër detyrimit nga KGJK-ja që çdonjëri prej tyre është i obliguar t'i zgjidhë 329 lëndë brenda vitit. Sikur të arrihej kjo normë, sistemi gjyqësor do të kishte rreth 9 mijë e 500 lëndë civile më pak", ka thënë Mërlaku. Moszbatimi i kontratave kolektive është arsyeja kryesore e ngritjes së numrit të lëndëve civile të pranuar nga gjyqësori. Sipas IKD-së, kjo jo me fajin e gjyqësorit, por të qeverisë që nuk ka ndarë buxhet për implementimin e këtyre kontratave, duke detyruar përfituesit që të drejtat e veta t'i realizojnë në rrugë ligjore, duke e ngarkuar gjyqësorin me lëndë dhe duke e dëmtuar buxhetin me



shpenzime procedurale. Mërlaku ka shtuar se për të marrë epilog një lëndë civile, vetëm në shkallë të parë, qytetarët duhet të presin gjithsej 3.8 vjet, kurse mesatarja e kohëzgjatjes së trajtimit të lëndëve nga Gjykata e Apelit është 1.7 vjet. Gjykatat themelore dhe degët e tyre gjatë vitit 2022 kanë pasur në punë lloje të ndryshme të kontesteve, duke përfshirë kompensimin e dëmit, kontestet familjare, të punës, shpifje dhe fyerje, konteste që rrjedhin nga kontratat kolektive etj.

Sipas të dhënave të KGJK-së, gjykata më e ngarkuar me lëndë del të jetë ajo e Prishtinës me një total prej 32 453 lëndësh, ndërsa gjykata më e pak e ngarkuar del të jetë Gjykata Themelore në Mitrovicë, dega në Zubin Potok me gjithsej 39 lëndë në punë.

"Sipas llogaritjeve të KGJK-së, të bëra në bazë të një formule të Komisionit Evropian për Efikasitet të Drejtësisë (CEPEJ), mesatarja e kohëzgjatjes së lëndëve të zgjidhura vetëm në shkallë të parë është 1 415 ditë. Kjo i bie se për të marrë epilog një lëndë civile, vetëm në shkallë të parë, qytetarët duhet të presin gjithsej 3.8 vjet. Sipas së njëjtës formulë, mesatarja e kohëzgjatjes së trajtimit të lëndëve nga Gjykata e Apelit është 638 ditë apo 1.7 vjet. Kështu, në total, kohëzgjatja e një lëndë civile nga momenti i parashtrimit në gjykatë e deri në momentin kur e njëjta përfundon në Gjykatën e Apelit është gjithsej 5.5 vjet. Mesatarja e përgjithshme e kohëzgjatjes së lëndëve gjyqësore qartazi flet për një trajtim të lëndëve gjyqësore civile brenda një afati jo të

arsyeshëm kohor. Në këtë drejtim, IKD-ja ka gjetur se kanë ndikuar shumë faktorë, duke nisur nga keqadministrimi i institucioneve administrative dhe performanca e gjykatave, edhe nga administrimi joadekuat i drejtësisë", ka thënë Mërlaku. Edhe më e rëndë situata duket të jetë te kohëzgjatja e trajtimit të lëndëve lidhur me çështjet pronësore në shkallë të parë e që IKD-ja ka theksuar se është 9 vjet e 3 muaj.

Nuraje Bllaca, hulumtuese në IKD, ka thënë se gjetjet tregojnë se kohëzgjatja në trajtimin e këtyre rasteve paraqet zvarritje të veçantë përtej zvarritjes së përgjithshme. "Zvarritja në këto raste është një zvarritje më specifike se zvarritja në përgjithësi e rasteve për arsye se mesatarja e trajtimit të rasteve

pronësore del të jetë 9 vjet e 3 muaj në shkallë të parë krahasuar me rastet që dalin nga kontratat kolektive, nga analizimi i 20 aktgjykimeve të tilla del të jetë mesatarja e trajtimit 1 vit e 7 muaj. Kjo diferencë e madhe bën që sistemi i drejtësisë në vitin 2022 ta anashkalojë trajtimin e rasteve pronësore dhe të fokusohet në rastet e kontratave kolektive", ka thënë Bllaca.

Bllaca ka shtuar se edhe Gjykata e Apelit nga 20 aktgjykime 14 raste i ka kthyer në rigjykim dhe rigjykimi i rasteve dhe kthimi në rivendosje dhe rigjykim ka bërë që të ketë një zvarritje më të madhe të rasteve pronësore. "Mesatarja nga vendimi i shkallës së parë në vendimin e shkallës së dytë si Gjykata e Apelit ka qenë 3 vjet e 5 muaj mesatarja, kurse 7 vjet e 8 muaj del të jetë nga parashtrimi i padisë në rastet pronësore deri te një vendim i shkallës së dytë, por pa e përmendur fare rastin e procedurës së kthimit në rigjykim", ka thënë Bllaca.

Raporti i prezantuar është rezultat i monitorimit të drejtpërdrejtë që Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) i ka bërë drejtësisë civile në Kosovë. IKD-ja ka monitoruar gjithsej 492 seanca gjyqësore të natyrës civile vitin e kaluar. Prej tyre, 401 seanca janë mbajtur, derisa 91 të tjera janë shtyrë. Shprehur në përqindje, i bie se 81.5 për qind e seancave gjyqësore civile janë mbajtur, kurse 18.5 për qind e tyre janë shtyrë.

Arsyeja më e madhe e shtyrjes së seancave gjyqësore del të jetë mungesa e paditësit (37 raste), pasuar nga mungesa e të paditurit (35 raste). Por, në jo pak raste edhe vetë gjykatësit kanë qenë arsyeja pse seancat gjyqësore në rastet civile janë shtyrë.

Komuna e Mitrovicës shpërndan 85 motokultivatorë për fermerët

MITROVICË, 2 GUSHT (ER) - Komuna e Mitrovicës ka ndarë 85 motokultivatorë për fermerët mitrovicas në mënyrë që atyre t'u krijojë kushte sa më të mira të punës.

Me rastin e shpërndarjes së

motokultivatorëve ka marrë pjesë edhe kryetari i kësaj komune, Bedri Hamza, i cili i ka uruar fermerët përfitues. "Shpreh falënderime dhe mirënjohje për Fondacionin 'Islamic Relief', i cili na ka mbështetur për realizimin e

shumë projekteve. Uroj të gjithë fermerët përfitues, ndërsa përpjekjet tona për rritje të subvencioneve në sektorin e bujqësisë do të vazhdojnë edhe në të ardhmen", ka deklaruar Hamza.



Lipjani përfiton dhjetë projekte nga MAPL-ja, Ahmeti dhe Krasniqi inspektojnë punimet

LIPJAN, 2 GUSHT (ER) - Komuna e Lipjanit ka fituar dhjetë projekte nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në kuadër të Grantit të Performancës. Me këtë rast kryetari i kësaj komune, Imri Ahmeti dhe ministri i MAPL-së, Elbert Krasniqi, kanë inspektuar të mërkurën implementimin e disa projekteve.

Fillimisht ata kanë vizituar sallën sportive në Shkollën e Mesme të Ulët "Ismail Luma" në Lipjan dhe disa të tjetra në fshatin Banullë. Ahmeti e ka falënderuar Krasniqin për mbështetjen për realizimin e projekteve të përbashkëta. Ai ka thënë se në kuadër të Grantit të Performancës, Lipjani i ka fituar 10 projekte. "Sot në vizitë në punët që po zhvillohen e kemi ministrin Elbert Krasniqi për t'i vizituar projektet që janë në kuadër të Grantit të

Performancës. Është mirë që po realizohen me kohë dhe e falënderoj ministrin Krasniqi për kohën e ndarë që të jetë në vizitë në projektet që janë në bashkëfinancim me MAPL-në", është shprehur Ahmeti.

Ndërsa ministri i MAPL-së, Elbert Krasniqi, ka thënë se projektet e financuara nga kjo ministri do të përfundojnë brenda këtij viti dhe se komuna e Lipjanit do ta ketë mbështetjen e vazhdueshme. "E dini se si qeveri kemi filluar programet për sporte dhe sigurisht se do të ndikojnë drejtpërdrejt. Komuna e Lipjanit është përfituese e grantit dhe është një nga komunat që ka pasur mbështetje të vazhdueshme. Sipas projekt-menaxherëve, projektet do të përfundojnë brenda këtij viti dhe do të ftohemi të gjithë që t'i shohim punimet e përfunduara", ka thënë Krasniqi.



Stacioni i Policisë në Klinë merr donacion nga KFOR-i

KLINË, 2 GUSHT (ER) - Policia e Kosovës ka njoftuar se në ambientet e Stacionit të Policisë në Klinë, komandanti i këtij stacioni, kapiten Ragip Bytyqi, ka pranuar një donacion për "dhomën mike", i cili do të përdoret nga hetuesit e dhunës në familje për intervistimin e viktimave të dhunës në familje dhe personave të mitur.

Ky donacion është dhuruar nga komandanti i Brigadës Perëndimi të KFOR-it, kolonel

Gabriele Vacca. Në ceremoninë e pranimit të donacionit ka qenë e pranishme edhe nënkryetarja e komunës së Klinës, Marqe Selmanaj. "Policia e Kosovës do të jetë gjithmonë falënderuese dhe mirënjohëse për ndihmën e ofruar si dhe bashkëpunimin e vazhduar në fusha të ndryshme dhe atë të sigurisë. Ky donacion do të shërbejë për punë më efikase në 'dhomën mike' në stacionin policor në Klinë", ka njoftuar policia.

Mbingarkohet Klinika e Pediatriisë në QKUK

PRISHTINË, 2 gusht (ER) - Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar se është mbingarkuar Klinika e Pediatriisë në QKUK. Sipas njoftimit të ShSKUK-së, në gjashtëmuorin e parë të këtij viti janë bërë mbi 19

mijë vizita pediatrike. "19 364 vizita emergjente pediatrike ka pasur për gjashtë muajt e parë të vitit 2023 në kuadër të Klinikës së Pediatriisë, duke e bërë njërën nga klinikat më të ngarkuara në Qendrën Klinike Universitare të

Kosovës. Prej tyre ka pasur 3 400 fëmijë të spitalizuar për trajtim të mëtejshëm, me mbi 25 mijë ditë shërimi për fëmijët, po ashtu 10 mijë vizita ambulatore në profile të ndryshme pediatrike", ka njoftuar ShSKUK-ja.



Kosova rekruton punëtorë aziatikë

PRISHINË, 2 GUSHT - Bangladeshi, Nepali, India dhe Turqia janë shtetet nga të cilat disa kompani të Kosovës kanë kthyer sytë për fuqi punëtoare. Arsyeja? Ka mungesë të punëtorëve vendës. H. Th., nga një kompani në fushën e ndërtimit në Malishevë, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se që dy muaj kanë marrë disa punëtorë nga Bangladeshi, shtet në Azinë Jugore. "Aktualisht i kemi 13-14 punëtorë nga Bangladeshi. I kemi marrë para dy muajsh. Ata kryejnë punë në ndërtim, janë punëtorë fizikë. Nuk janë profesionistë në këtë lëmë, por po mësohen", ka thënë ai, duke mos dashur të specifikojë më shumë.

Numri i punëtorëve në këtë kompani është mbi 60 dhe nevoja për më shumë punëtorë është në rritje, kanë thënë udhëheqës të kësaj kompanie.

"REL"-i ka kontaktuar edhe disa kompani të tjera që kanë marrë punëtorë nga këto shtete aziatike, por shumë prej tyre kanë hezituar të flasin publikisht. Se numri i punëtorëve të huaj në Kosovë është rritur muajt e fundit dëshmohet nga të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në periudhën janar-qershor të këtij viti janë bërë 1 858 kërkesa për leje qëndrimi në Kosovë për qëllim pune nga shtetas të huaj. Ndërkaq, 1 391 kanë fituar leje qëndrimi të përkohshëm. Në këto kërkesa, me numrin më të madh prijnë shtetasit nga Turqia dhe Bangladeshi. Në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar numri i personave që kanë fituar leje qëndrimi të përkohshëm me qëllim pune ishte 1 317.

Por, punëtorët që vijnë në Kosovë nga shtetet aziatike nuk janë të kualifikuar dhe vështirë përshtaten me rrethanat në Kosovë. Kështu ka thënë Ramiz Ismajli, i cili punon në një kompani që rekruton punëtorë nga shtetet e treta. "Në fushën e ndërtimit (punëtorët e huaj) nuk janë stabilë. Ka raste kur gënjëjnë për përvojën e tyre të punës. Kur vijnë në Kosovë për të punuar, del se as 30 për qind të asaj që e kanë paraqitur në CV (rezymë) nuk e dinë. Nuk janë punëtorë si ne kosovarët, që shkojmë dhe punojmë në Gjermani. Ne mësojmë shpejt, këta që vijnë nga këto vende nuk janë të tillë. Pastaj, nuk flasin gjuhë të huaja, si anglishtja, dhe është i vështirë komunikimi", ka



thënë Ismajli për "Radion Evropa e Lirë".

Ai ka treguar se ka shumë kërkesa nga kompani të profileve të ndryshme në Kosovë për rekrutimin e punëtorëve nga shtetet aziatike, por janë disa procedura administrative që paraqesin vështirësi. "Janë disa kompani që ua kam dhënë kontaktin dhe CV-të e disa punëtorëve nga vendet aziatike, por sa arrijnë t'i marrin? Ka shumë procedura administrative", ka thënë Ismajli.

Mungesë e punëtorëve vendës

Përkundër shkallës së papunësisë që arrin në mbi 16 për qind, Kosova ka vite që përballlet me mungesë punëtorësh të profileve të ndryshme.

Gastronomia, ndërtimtaria, bujqësia dhe tekstili janë sektorët me mungesën më të madhe të punëtorëve në Kosovë. Interesimi i qytetarëve të Kosovës për të punuar, sidomos në sektorin privat, ka rënë për disa arsye. Sipas Inspektoratit të Punës, këto arsye lidhen me orarin e stërzgatur të punës, pagat e ulëta, mungesën e kontratës, punën në fundjavë, mospagesën e orëve shtesë e të tjera. Një tjetër arsye që ka çuar në krizë për punëtorë në Kosovë është edhe emigrimi i

qytetarëve. Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës flasin për mbi 42 000 qytetarë të larguar nga Kosova në vitin 2021, për arsye të ndryshme, ndër to edhe për qëllime pune.

Rafuna: Punëtorët, për periudhë afatshkurtër

Në Odën Ekonomike të Kosovës (OEK) kanë thënë se janë dhjetëra kompani që tashmë kanë punësuar punëtorë nga vendet e tjera, kryesisht aziatike, dhe po aq kompani janë në kërkim të fuqisë punëtoare nga jashtë.

Sektorët me më së shumti punëtorë nga vendet aziatike janë ai i ndërtimit dhe ai i gastronomisë. "Kërkesa për fuqi punëtoare nga jashtë është në rritje. Fuqia punëtoare po na vjen nga Bangladeshi, Turqia, Nepali dhe vendet e tjera", ka thënë Rafuna për "REL"-in. Megjithatë, Rafuna ka thënë se Kosova nuk po arrin ta luftojë mungesën e fuqisë punëtoare me marrjen e punëtorëve nga vendet e tjera. Sipas tij, kompanitë vendore po raportojnë se fuqia punëtoare që po vjen nga vendet aziatike është e pakualifikuar dhe vështirë po ambientohet me rrethanat e punës në Kosovë. Sipas Rafunës, nga informacionet që merr nga kompanitë, shumica e këtyre punëtorëve nuk e kanë qëllim

final tregun e punës në Kosovë. Një pjesë e tyre, thotë ai, qëndrojnë në Kosovë vetëm derisa të gjejnë një mundësi për të shkuar në shtetet e Bashkimit Evropian. Sipas kreut të OEK-ut, kjo po bën që kompanitë të mos e mbështetin aktivitetin e tyre në këtë fuqi punëtoare në një periudhë afatmesme apo afatgjatë. "Punëtorë të cilët vijnë nga vendet e treta lidhin kontrata pune me paga dhe kushtet që ofron kompania bazuar edhe në legjislacionin në fuqi siç është Ligji i Punës", ka thënë ai. Punëdhënësi më i madh në Kosovë është sektori privat, me më shumë se 300 mijë të punësuar. Paga mesatare bruto në sektorin privat është 473 euro. Rafuna ka thënë se institucionet duhet të bëjnë përpjekje që të ndërtojnë politika për ta parandaluar ikjen e madhe të fuqisë punëtoare, pasi që humbjet në aspektin ekonomik do të jenë të mëdha. "Ne duhet ta kem synim ta ndalim emigrimin. Nëse nuk mund të ndalim, ta sjellim në minimumin e mundshëm duke ofruar një sistem adekuat arsimor, një sistem të sundimit të ligjit efikas, një sistem të mirë të shëndetësisë dhe duke krijuar siguri juridike dhe ekonomike për të rinjtë", ka thënë Rafuna. Një anketë e Institutit Republikan

Ndërkombëtar, me seli në Shtetet e Bashkuara, e publikuar në nëntor të vitit 2021, ka treguar se 78 për qind e kosovarëve të moshës 18 deri në 35 vjeç "ndoshta" ose "përfundimisht" do të largoheshin nga vendi i tyre nëse do të kishin mundësi.

Çfarë thotë Ligji për Punëtorët e Huajt?

Punësimi i shtetasve të huaj në Kosovë është i rregulluar me Ligjin për të Huajt. Sipas këtij ligji, personat fizikë, që nuk janë shtetas të Kosovës, kur dëshirojnë të punojnë në territorin e Kosovës, duhet të pajisen me leje pune. Për lejeqëndrim me qëllim të punës, shtetasi i huaj duhet të grumbullojë një varg dokumentesh – në mesin e tyre: kontratën e punës, dëshminë që nuk është i dënuar, dëshminë për arsimimin dhe kualifikimin që ka, sigurimin shëndetësor e të tjera. Mbledhja dhe procedimi i tyre shpesh marrin muaj të tërë kohë. Leja e qëndrimit të përkohshëm për qëllime pune lëshohet për 6 muaj deri në 1 vit. Pas kësaj periudhe, kjo leje ripërtërihet dhe mund të merret edhe leje e përhershme qëndrimi. Me trendin e mungesës së fuqisë punëtoare po përballen edhe Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

KMDLNj: Ligji i ri për skemat pensionale, ambalazhimin e ka mashtrues

Prishtinë, 2 gusht - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka vlerësuar se plotësimi i Ligjit nr. 04/I-131 për skemat pensionale nuk i plotëson kërkesat e pensionistëve. Ky këshill ka theksuar se ndryshim i ligjit nuk paraqet asnjë zgjidhje vetëm sa e zgjatë agoninë e pensionistëve të cilët përballen me probleme ekzistenciale. Sipas KMDLNj-së, ky ligj është me përmbajtje

mashtrore për pensionistët. "Ky ndryshim i ligjit për KMDLNj-në nuk paraqet asnjë zgjidhje vetëm sa e zgjatë agoninë e pensionistëve të cilët përballen me probleme ekzistenciale, në mungesë të bashkëpunimit me partnerët socialë dhe improvizimeve të këtij Ligji që ambalazhimin e ka mashtrues, ndërsa përmbajtjen dëshpëruese. Propozuesja e këtij ligji, Qeveria e Kosovës, nuk ka

dalë me propozim konkret për rritjen e pensioneve, që nënkupton se po luhet një lojë për të fituar kohë. KMDLNj-ja mendon se pensionistët duhet të kompensohen për kohën sa kanë qenë të diskriminuar me paragrafin 2 të nenit 8 e jo që kjo kohë të mbulohet me atë se asnjë ligj nuk prodhon efekt retroaktiv", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.



Grurë sivjet, pak e me cilësi të dobët

PRISHTINË, 2 GUSHT - Kosova sivjet nga sezoni i korrje-shirjeve nuk do të mund t'i plotësojë nevojat e saj për grurë. Kjo kulturë bujqësore këtë vit nuk ka as cilësi të mirë. Fermeri Korab Sejdiu nga komuna e Podujevës ka korrur mbi 150 hektarë sipërfaqe të mbjellë me grurë, por këtë vit sasia e grurit që ka siguruar ka qenë më e vogël. "Deri 3 000 kilogramë grurë për një hektar të kultivuar kemi arritur të sigurojmë sivjet, gjysmën e sasisë krahasuar me vitin e kaluar", ka thënë Sejdiu për "Radion Evropa e Lirë".

Për shkak të sasisë më të vogël të grurit të korrur, Sejdiu ka thënë se "sivjet nuk ka bukë dhe kualiteti është i dobët". Për këtë gjendje fermeri ua lë fajin kushteve klimatike që këtë vit kanë qenë të pafavorshme për bujqit. "Ka pasur shumë reshje shiu, mjegull, brymë mëngjesi", ka thënë ai, duke sqaruar se kjo ka bërë që gruri të mos fryhet aq sa duhet.

Për shkak të kushteve jo të favorshme atmosferike, këtë vit fushata e korrje-shirjeve ka nisur më 15 korrik, teksa rëndom nis në fillim të këtij muaji. Sipas ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, këtë vit kanë qenë të mbjellë me grurë rreth 67 000 hektarë tokë.

Ndërsa fermeri Valon Vehapi nga komuna e Lipjanit ka thënë se sasia më e vogël e rendimenteve të grurit këtë vit është shkaktuar edhe nga mostrajtimi i duhur i kësaj kulture bujqësore. Ai tashmë ka korrur mbi 100 hektarë tokë me grurë. Edhe Vehapi, sikurse Sejdiu, sivjet ka siguruar më pak grurë sesa ka pritur, pasi ai ka synuar 7 000 kilogramë për një hektar, por ka siguruar deri në 5 000.

"Kushtet klimatike nuk kanë qenë ideale për bujqësi, as për kulturën e grurit e as për të misrit, për arsye se muaji maj dhe qershor kanë qenë të ftohtë dhe të lagësht. Për shkak të lagështisë së madhe janë shfaqur shumë sëmundje që i kanë bërë dëm bimës së grurit. Kjo ka ndikuar edhe në tokën time pasi, siç e kam punuar tokën dhe e kam trajtuar bimën duke punuar 12 orë në ditë, kam pritur deri në 7 000 kilogramë për hektar, por kam dalë me pak më shumë se 5 000 kilogramë", ka thënë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Nga Federata Sindikale e Bujqve e Kosovës kanë thënë se temperaturat e ulëta gjatë pranverës ulën pritjet për prodhim të bollshëm të grurit. Kreu i kësaj federate, Tahir Tahiri, ka thënë se mesatarja e prodhimit për hektar këtë vit do



të jetë më e ulët krahasuar me vitet e kaluara. Megjithatë, ai nuk ka treguar se sa për qind të nevojave të saj për grurë do të arrijë t'i sigurojë Kosova këtë vit. "Kam frikë se do të jetë viti më i dobët dhe më i vështirë sa i përket prodhimit të vendore. Unë nuk mbaj mend që në 40 vjet të ketë pasur lagështi nga muaji mars, prill, maj dhe qershor. Kemi pasur vërshime, breshër... Por, më e rënda ka qenë lagështia e stërzgatur, e cila ka krijuar kushte për paraqitjen e sëmundjeve të ndryshme", ka thënë ai.

Disa zona në Kosovë gjatë këtij viti janë përballur me vërshime. Në janar, komuna e Skenderajt,

ajo e Mitrovicës së Jugut, e Klinës dhe e Istogut janë goditur nga vërshimet. Ndërkaq, në qershor, komuna e Pejës u përball me vërshime. Përveç sasisë së pamjaftueshme të grurit që Kosova ka siguruar sivjet, cilësia e tij nuk është e duhur, ka thënë udhëheqësi i Shoqatës së Mullisëve të Kosovës, Bashkim Zejnullahu. Ai ka shpjeguar se cilësia e kësaj kulture bujqësore varet nga rajonet ku mbillet. Rrafshi i Kosovës, ku gjendet edhe komuna e Lipjanit, sipas tij, ka pasur rendiment dhe cilësi të mirë. Por, cilësia e grurit në rajonet e tjera, sipas Zejnullahut, nuk garanton se ai

mund të përpunohet dhe të prodhohet miell.

"Gruri duhet të ketë një cilësi minimale për përpunim të miellit. Gruri i këtij viti ka pasur një kualitet aq të dobët, sa nuk ka mundësi të prodhohet miell. Ky grurë, i këtij kualiteti, mund të përpunohet si ushqim për kafshë, por jo si ushqim për njerëzit", ka thënë ai.

Gruri është lënda e parë për prodhimin e miellit dhe, si i tillë, konsiderohet produkt strategjik për sigurinë kombëtare.

"Radio Evropa e Lirë" ka pyetur edhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për sasinë dhe cilësinë e grurit, por deri në publikimin e këtij teksti ky institucion nuk ka kthyer përgjigje. Sipas të dhënave zyrtare të vitit 2021, konsumi mesatar i grurit për kokë banori, duke përfshirë edhe produktet me përmbajtje gruri, janë 207 kilogramë, ose mbi 410 000 tonë grurë. Por, prodhimi vendor ndër vite ka qenë rreth 300 000 tonë grurë. Kjo ka bërë që Kosova t'i përmbushë nevojat me këtë produkt përmes importit. Në vitin 2021 nga fermerët e Kosovës ishin prodhuar 280 000 tonë grurë. Sipas të dhënave të Doganave të Kosovës për atë vit, 115 000 tonë lloje të grurit dhe miellit janë importuar nga shtete të ndryshme të Evropës.

Çfarë nënkupton rreth -5 miliardë euro deficit tregtar në vit?



Nga Shenoll MUHARREMI, njohës i ekonomisë

Mund të bankrotojmë si shtet. Është temë serioze. Shpjeguar më së thjeshti, më shumë miliarda humbim jashtë sesa i gjithë buxheti i konsoliduar i

Kosovës. Nëse i kemi rreth -5 miliardë euro deficit, e buxhetin publik rreth 3.2 miliardë, i bie që gati 2 miliardë euro është më e madhe humbja totale sesa shpenzimet e buxhetit publik. Kjo i bie si një shtëpi që i harxhon 100 euro e i ka vetëm 50 euro. Ato 50 euro nuk i fiton ekonomia e shtëpia. Ato vijnë nga jashtë (diaspora) dhe informaliteti. Mënyra tjetër e shpjegimit është që shtëpia i fiton 100 euro, por 50 euro ia marrin të tjerët dhe nuk i gëzon ato 50 euro u bërë më e

mirë, me investuar në arsim, shëndetësi dhe biznes. Është çështja më e ndejshme negative strukturore ekonomike në Kosovë. Cili është plani i qeverisë? Nuk ka plan fare. Kur e keni dëgjuar një qeveritar duke folur për zëvendësimin e importeve me produkte vendore? Apo shikoni më së miri sa për qind e buxhetit publik apo GDP-së investohet me rregulluar strukturën kronike negative tregtare. Asnjë cent thuajse. Askush nuk merret me këtë çështje, fatkeqësisht. I kemi

disa biznese që viteve të fundit kanë filluar me rritë sadopak eksportin. Qeveria, në vend se me i përkrahë, po i sulmon disa prej tyre dhe po i kërcënon me i mbyllë. Kjo është kundër interesit shtetëror dhe ekonomik të vendit. Frikësimi i bizneseve dhe largimi i investitorëve potencial rrezikon seriozisht qëndrueshmërinë e shtetit dhe ardhmërisë së Kosovës. E kemi një situatë absurde ku jo vetëm që qeveria nuk iu ndihmon bizneseve me eksportuar dhe zëvendësuar

importin me produkte vendore..., ajo rrjedhimisht i kërcënon dhe tenton me i mbyllë bizneset. Kjo assesi nuk do të kalojë dhe qëndrojnë se do të bankrotojnë shteti. Mos të kishte qenë diaspora me ndihmu, Kosova kishte bankrotuar moti. Por, nëse tash ne i shkatërrojmë bizneset që eksportojnë apo që rrisin eksportin, diaspora nuk ka kapacitet me paguar edhe më shumë. Rrjedhimisht, vendimet, qasja dhe politikat e tilla qeveritare mundën me bankrotuar Kosovën.

Vetëvendosja: Kosova me normën më të ulët të inflacionit në rajon

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Lëvizja Vetëvendosje, e cila udhëheq qeverinë, ka bërë me dije të mërkurën se Kosova ka normën më të ulët të inflacionit në rajon me vetëm 2.8 për qind. Këtë statistikë kjo lëvizje e ka bërë publike duke cituar të dhënat e "Trading Economics", ku thuhet se norma vjetore e inflacionit në Kosovë në muajin e qershor të këtij viti ka rënë në 2.8 për qind nga 4.3 për qind.

"Norma vjetore e inflacionit

në Kosovë në muajin e gjashtë (qershor) 2023 ka rënë në 2.8 për qind nga 4.3 për qind sa ishte evidentuar në muajin e pestë (maj) 2023, duke shënuar kështu normën më të ulët të inflacionit prej muajit qershor 2021, thotë matja e "Trading Economics", ka njoftuar Vetëvendosja. Sipas matjeve të "Trading Economics", në Kosovë kategoria më e rëndësishme në indeksin e çmimeve të konsumit janë ushqimet dhe pijet joalkoolike (40 për qind e


peshës totale). "Transporti zë 16 për qind, mobilie, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje për 8 për qind, banesat dhe shërbimet komunale për 7 për qind dhe pijet alkoolike e duhani për 6 për qind. Veshje dhe këpucë, komunikim, rekreacion dhe kulturë, restorante, hotele, shëndeti, arsimit dhe mallrat dhe shërbimet e ndryshme përbëjnë 24 për qind të peshës së përgjithshme", ka njoftuar partia e kryeministrit Albin Kurti.

Kosova me shkallën më të ulët të inflacionit në rajon për muajin qershor

1. Kosova	2.8%
2. Shqipëria	4.5%
3. Bosnja dhe Hercegovina	4.8%
4. Sllovenia	6.1%
5. Mesatarja e shteteve të BE-së	6.8%
6. Kroacia	7.4%
7. Mali i Zi	7.5%
8. Bulgaria	8.7%
9. Maqedonia e Veriut	9.3%
10. Serbia	13.7%

Burimi: Trading Economics

Të gjithë janë specialistë të thashethemeve



Nga: David RANDALL

Një herë e një kohë, kur Interneti ishte ende një risi, pothuajse nuk kalonte një ditë pa dalë një artikull që paralajmëronte “vdekjen e gazetarisë”. Sot, njëzetë vjet më vonë, ato parashikime tingëllojnë qesharake, sepse praktikisht të gjithë lajmet na mbërrijnë ende prej mjeteve tradicionale të informimit dhe prej gazetarëve profesionistë. Gazetaria, mund ta them me një farë lehtësimi, nuk ka mbërritur ende në pikën e përfundimit në varrezën e zanateve të vjetruar.

Të paktën jo e gjitha. Por, ka një kategori gazetarësh që ndoshta i ka hyrë asaj rruge: specialistët e thashethemeve. Thashethema është një aspekt i çuditshëm i zanatit tonë. Nëpër tabloidë, rubrikat që zyrtarisht rezultojnë të shkruara nga një gazetar i vetëm, në të vërtetë bëhen bashkë prej ekipesh me të rinj ambiciozë që frekuentojnë aktivitetet mondane apo ngjiten pas telefonit, në kërkim të lajmeve. Në gazetë londineze më serioze, të cilat i quajnë “ditaristë” gazetarët e tyre të specializuar në thashetheme, ata që njoh janë

ose personazhe të shoqërisë së lartë që nuk humbasin asnjë festë, ose individë të neveritshëm që kanë aftësinë shqetësuese që të gjenden vetëm pak hapa larg – sa herë që ndodh diçka. Dhe, janë gjithmonë këta të dytët, që zbulojnë lajmet më të mirë.

Por, këta zotërinj janë vetëm hijet moderne të specialistëve të kronikës rozë, të të kaluarës sonë të palavdishme. Gazeta e parë që ka patur një rubrikë thashethemesh ka qenë New York Times në vitin 1840. Pak më vonë lindi argëtimi në masë dhe mbërritën njerëzit e famshëm që, ashtu si sot, nuk ishin vetëm talentet e mëdhenj, por edhe persona të famshëm, për faktin e thjeshtë që ishin të famshëm.

Në fillim bëhej fjalë mbi të gjitha për aktore, aftësitë e pakta të të cilave në aktrim kompensoheshin prej bukurisë (që në vitet 1870, fotografitë e tyre shiteshin me miliona), si dhe jeta private plot ngjarje. Drejt fundit të shekullit, gazetarët ishin bërë tashmë mjeshtër të thashethemeve, që dikush e ka përkufizuar si “një lajm që na pëlqen, për një person i cili nuk na pëlqen”.

Në këtë fushë, askush nuk ishte më i zoti se sa koloneli

William D’Alton Mann, në revistën e të cilit, Town Topics, shfaqej një rubrikë që keqtrajtonte shoqërinë e lartë njujorkeze: “Zonja Van Elm duhet të ketë një problem në fyt. Përndryshe, përse vallë do të fillonte të pinte që në pikë të mëngjesit?” e kështu me radhë. Kishte hapur një zyrë në qendër dhe paguante bujarisht, këdo që i sillte një “kafshatë të shijshme”. Shtëpiakë, dyqanxhinj dhe rivalë kalonin nga ai, zbulonin atë që dinin dhe fusnin në xhep shpërblimin. Mann korruptonte edhe telegrafistët që t’i zbulonin ato gjëra që u dëgjonin veshët. Shpeshherë nuk i botonte menjëherë lajmet, por ofrohej që të mos zbulonte ata më komprometues, në këmbim të një huaje apo një investimi në një prej operacioneve të tij financiare. Natyrisht, “viktimat” nuk i shihnin më kurrë paratë e tyre. Në fund, agjenti i Mannit u arrestua për zhvatje dhe i gjithë mashtrimi përfundoi në gjykatë.

Vitet e artë të kronikës rozë ishin ata nga 1925-1950 dhe kishin si protagonistë tre “llafazanë të famshëm”. Rubrika e Walter Winchell, që merrej me Broadwayn, ishte një seri frazash të shkurtra të

ngjashme me ato që shfaqen me titra në kanalet e lajmeve. E botonin më shumë se një mijë gazeta dhe programi i tij radiofonik dëgjohej nga 50 milionë persona çdo javë. Pastaj ishin dy hundëgjatë të vjetër që merreshin me kinemanë, me një ligësi të pamëshirshme:


Hedda Hopper – mbretëria e terrorit e të cilës përmbli dhej më së miri në emrin që i kish vënë vilës së saj në Beverly Hills, “Shtëpia e ndërtuar nga frika” – dhe Louella Parsons e cila shfrytëzonte bashkëpunimin e bashkëshortit të saj të tretë, një urolog i cili kuronte sëmundjet veneriane të banorëve të Hollywoodit.

Personazhe të tillë nuk do të shohim kurrë më dhe duhet të pyesim nëse pas dhjetë vitësh, rubrikat e thashethemeve do të vazhdojnë të ekzistojnë, duke qenë se lajmet për njerëzit e famshëm tashmë shfaqen në faqet kryesore të shumë gazetave. Mjafton të shohësh Daily Mail, që sot ka faqen e lajmeve më të vizituar në botë, edhe falë thashethemeve që shfaqen në kolonën e saj të djathtë. Faqe si Buzzfeed, Tmz, dhe Popbitch përhapen me shpejtësi dhe kushdo që ka pasur qoftë edhe një rol

periferik në një seri televizive tashmë ka një zyrë shtypi që shkruan në Twitter në emër të tij, mbi dashuritë e tij dhe atë që ka ngrënë për mëngjes.

Një herë e një kohë, marrëdhëniet e supozuara jashtëmartesore të personazheve televizive zbuloheshin vetëm nga gazetatat. Sot jo më. Kohët e fundit, bashkëshortja e një prej këtyre të famshmeve e akuzoi të shoqin për tradhti bashkëshortore, në Facebook. Ai e përgënjeshtroi kategorikisht, por cilido prej të dyve të ketë të drejtë, gjëja më domethënëse është që, sapo bashkëshortja pati dyshimin për tradhtinë, ajo rendi ta shkruajë në Facebook. Rrjetet sociale kanë këtë efekt: njerëzit rrëfehen, akuzojnë dhe përsërisin në Twitter thashethemet mbi njerëzit e famshëm. Tashmë ekzistojnë edhe aplikacione për shkollat, ku studentët mund të hedhin në qarkullim fjalë të këqija për shokët dhe mësuesit, duke imituar personazhe si Winchell dhe Hopper. Në fund të fundit, për çfarë shërben Facebooku, nëse jo për të shkëmbyer gjëra që nuk i thua dot hapur? Me sa duket, tani të gjithë janë specialistë të thashethemeve.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Napoli insiston për shërbimet e Zhegrovës

NAPOLI, 2 GUSHT - Kampioni i Italisë, Napoli, po insiston për transferimin e Edon Zhegrovës gjatë këtij muaji, ka raportuar "Tuttosport" të mërkurën. Reprerentuesi i Kosovës po shihet te Napoli

si zëvendësim ideal për meksikanin Hirving Lozano, i cili do të transferohet në ShBA. Napoli është në negociata intensive me Lillen dhe për Zhegrovën është gati të ofrojë deri në 10

milione euro. 24-vjeçari është pjesë e ekipit francez prej vitit 2022 kur iu bashkua nga Baseli dhe ka kontratë deri në verën e vitit 2026. Në rast se Zhegrova do t'i bashkohej Napolit, atëherë

do të bëhej bashkëlojtar me Amir Rrahmanin, i cili është kapiteni i Kosovës. Zhegrova në edicionin e fundit shënoi 4 gola dhe asistoi 5 herë në 25 ndeshje të luajtura për Lillen në të gjitha garat.



Trajneri Duro dhe shtatë futbollistë largohen nga Gjilani

SC Gjilani edicionin e fundit luftoi për trofe dhe e përfaqësoi Kosovën në garat ndërkombëtare, kurse këto ditë po kalon nëpër një periudhë shumë të vështirë, pasi shumë futbollistë dhe trajneri Klodian Duro janë larguar nga klubi, kurse pritet të ketë edhe largime të tjera

EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 GUSHT - Finalisti i Kupës së Kosovës në futboll, Gjilani, është duke kaluar nëpër një situatë të vështirë. Brenda 24 orëve nga ky klub largimin e kanë konfirmuar trajneri Klodian Duro dhe shtatë futbollistë që e bartën barrën kryesore në kampionatin e fundit, në të cilin Gjilani përfundoi në vendin e tretë. Të martën largimet nga ky klub i konfirmuan Baton Zabergja, Mevlan Zeka, Arbër Prekazi Armend Halili,

kurse të mërkurën rrugën e tyre e ndoqën trajneri Duro dhe futbollistët Yll Hoxha e Përparim Islami si dhe kapiteni Besar Musolli.

Kapiteni Musolli ka vlerësuar privilegj mundësinë që pati ta bartë fanellën e klubit gjilanas dhe ta përfaqësojë këtë klub në rolin e kapitenit. "Ka qenë nder dhe privilegj që kam pasur mundësinë të vesh fanellën e Gjilanit dhe ta përfaqësoj këtë skuadër dhe si kapiteni i saj. Dua ta falënderoj përzemërsisht presidentin e klubit Florim Zuka. Mirënjohje për të gjithë tifozët,



veçanërisht 'Skifterat'. Falënderoj çdo anëtar të klubit, trajnerët, lojtarët që kam bashkëpunuar në këto sezona, pasi kemi kaluar shumë momente të veçanta. I uroj më të mirat Gjilanit në vijim", ka deklaruar 33-vjeçari Besar Musolli.

Trajneri Klodian Duro, që e kishte marrë drejtimin e klubit të Gjilanit më 26 qershor dhe e kishte drejtuar këtë skuadër në dy ndeshje më Ligën e Konferencës, e konfirmoi largimin në "Facebook". Trajneri nga Shqipëria ka thënë se po largohet

krenar nga klubi i Gjilanit. "Fund. U bashkuam pa e pritur njeri dhe po kështu po ndahemi. Në luftë shkohet me trima dhe trimat e mi luftuan si asnjëherë më parë në dy përballje shumë të forta ku ishim të pabarabartë në numër", ka shkruar Duro. "Në të parën 11 kundër 14 dhe në të dytën 10 kundër 14, por asnjëherë dhe në asnjë moment nuk u dorëzuam, por luftuam si heronj të vërtetë ashtu siç u ka hije trimave të kombit. Pritem deri në fund të gjithë bashkë për të luftuar përsëri në betejat që kishim para, por ishte e pamundur. Ishte shumë e bukur për aq sa zgjati dhe largohemi të gjithë me kokën lart si shqiponjë", ka shtuar Duro.

Nga Gjilani ditë më parë është larguar edhe mesfushori i njohur Albert Dabiqaj, i cili iu bashkua skuadrës së Dritës.

Liga e Konferencës, sonte paraqiten Drita, Ballkani dhe Dukagjini

Tri klubet e Kosovës do të paraqiten sonte në Ligën e Konferencës. Përderisa Ballkani thuajse e ka siguruar kualifikimin falë fitores 3-0 në ndeshjen e parë, Drita synon ta shfrytëzojë rezultatin e ndeshjes së parë 0-0 dhe me ndihmën e tifozëve të kualifikohet në raundin tjetër. Dukagjini e ka më vështirë, pasi luan në Kroaci ndaj Rijekës dhe ndeshjen e parë e ka humbur 0-1

EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 GUSHT - Nënkampionia e Kosovës në futboll, Drita, ka nxjerrë një rezultat të mirë në Çeki nga përballja me Viktoria Plzen (0-0) në kuadër të raundit të dytë kualifikues të Ligës së Konferencës. Tash skuadra e Dritës e kërkon kualifikimin në

ndeshjen e dytë që zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" në orën 20:00.

Trajneri i skuadrës gjilnase, Akil Vavalis, e vlerëson rezultatin e ndeshjes së parë, por thotë se çekët janë favoritë në këtë ndeshje. Ai beson se me përkrahjen e tifozëve dhe terrenin vendas mund të mposhtet kundërshtari. "Të enjten do të ballafaqohemi me Viktoria



Plzenin, që prapë do të jetë lojë e vështirë. Pres që ndeshja e dytë të jetë edhe më e vështirë se ndeshja e parë në Çeki. Ne në ndeshjen e parë kishim rezultat të mirë, por

kjo nuk thotë asgjë pasi kemi edhe 90 minuta shumë të vështirë. Pres të njëjtin angazhim edhe në ndeshjen e dytë. Ekipi i Viktoria Plzen është favorit. Ne do të kemi

një përparësi sa i përket fushës dhe mbështetjes së madhe të tifozëve", ka thënë Vavalis në konferencë për medie një ditë para ndeshjes.

Edhe dy klubet e tjera të Kosovës do të paraqiten sonte në Ligën e Konferencës. Skuadra kampione e Superligës, Ballkani, ka shkëlqyer në ndeshjen e parë ndaj Larnes në "Fadil Vokrri", duke fituar me rezultat të pastër 3-0, kurse kualifikimi në fazën tjetër është shumë i mundshëm. Në anën tjetër, Dukagjini i Klinës e ka humbur përballjen e parë me skuadrën e Rijekës si vendas me rezultat 0-1, kurse në Kroaci do ta ketë edhe më të vështirë, por në futboll asgjë nuk është e pamundur dhe djelmohat e trajnerit Armend Dallku do t'i provojnë shanset.

Sot dalin në shitje biletat për ndeshjen Kosovë - Danimarkë

Prishtinë, 2 gusht - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) njofton se sot (e enjte) fillon shitja e biletave për ndeshjen Kosovë - Danimarkë. Këtë herë biletat do të shiten në Prizren,

Prishtinë, Pejë dhe Mitrovicë. Çmimi i biletës është 3 euro. Në Prizren do të shiten më 3, 4 dhe 5 gusht "Te Shadërvani", në Prishtinë më 4 gusht tek amfiteatri "Zahir Pajaziti", në

Mitrovicë dhe Pejë "Te Fan Club" më 4 dhe 5 gusht. Ndeshja Kosovë - Danimarkë zhvillohet të shtunën (më 5 gusht) në Prizren në Rrethin e Tretë Parakualifikues për

"Eurobasket 2025". Kjo është sfidë shumë e rëndësishme për "dardanët" dhe kërkohet mbështetja e tifozëve për t'u kualifikuar në kualifikimet e "Eurobasket 2025".



Te Red Bulli tallen me rivalët: Verstappeni fiton edhe po të niset nga vendi i fundit

MILTON KEYNES, 2 GUSHT - Dominimi që Red Bulli ka këtë sezon në Formula 1 është i paprecedentë. Një skuadër që i ka fituar të 12 garat e zhvilluara deri më tani, nga të cilat 10 i ka fituar një pilot i vetëm, Max Verstappeni. Edhe

në garën e fundit holandezi ishte një përbindësh, duke fituar garën edhe pse u nis nga vendi i gjashtë. Duket se për Verstappenin nuk ka rëndësi pozicioni se nga niset, pasi me një makinë të tillë ai arrin të fitojë gjithnjë. Madje duke

lënë pas me më shumë se 30 sekonda rivalët e tij, siç ndodhi në Belgjikë, ku i la targën edhe shokut të tij të skuadrës, që u rendit i dyti. Konsulenti sportiv i Red Bullit, Helmut Marko, një nga drejtuesit e kësaj skuadre, ka thumbuar të

gjithë rivalët e skuadrat e tjera, duke parë dominimin e Verstappenit. "Me shumë gjasa Max do ta fitonte garën edhe po të nisej nga vendi i fundit. Për pilotët e tjerë, vendi i dytë pas atij është si një fitore", ka thënë Helmut Marko.



Marku bën premtimin e madh: Dua të hedh KO kundërshtarin tim

TIRANË, 2 GUSHT - Boksieri shqiptar Florian Marku do të përballet me irlandezin Dylan Moran më 2 shtator në "A0 Arena" të Manchesterit. Duke folur për këtë sfidë për "Sky Sports", Marku, i pamposhtur në ring, ka thënë: "Unë do ta hedh KO rivalin dhe pastaj kush e di se çfarë do të ndodhë. Ndoshta do të luftoj me dikë nga eventit kryesor (Smith-Eubank)". Që kur pësoi një humbje në Amerikë në vitin 2019, humbja e vetme në karrierën e tij, Moran ka një seri prej tetë fitoresh radhazi në ring. Ndërsa Marku rikthehet në ring pasi mposhti Miguel Parra në Tiranë vitin e kaluar. Shqiptari këmbëngul se nuk do të jetë i ndryshkur pasi ka qenë jashtë për caq gjatë. "Ndihej krejt i ri. Mezi pres të futem në ring", ka thënë Marku. "Unë luftova vetëm me një dorë në sfidën time të fundit në Shqipëri, u lëndova vërtet para



atij dueli. Por tani, gjithçka është mirë. Po stërvitem shumë fort, në gjashtë muaj nuk e kam ndërprerë stërvitjen. Më 2 shtator ne do të luftojmë në ring", ka shtuar Marku. "Unë jam

agresiv në ring. Dua gjithmonë të argëtoj. Unë them para se të futem në ring: Do të jem më i qetë. Kur futem në ring, dua të hedh KO kundërshtarin tim", u shpreh Florian Marku.

Klopp: Vetëm City për titull, ne të tjerët për top katërshe

LIVERPOOL, 2 GUSHT - Jurgen Kloppi është i bindur se vetëm Manchester City është i denjë për titullin kampion në Ligën Premier. Përkundër se tifozët e Liverpoolit presin që skuadra e tyre të kthehet në luftë për titullin kampion, ndryshe mendon trajneri Jurgen Klopp. Trajneri gjerman ka thënë se skuadrat e tjera duhet të luftojnë vetëm për një pozitë në Ligën e Kampionëve, pasi për titull është shumë e vështirë. "Mendoj se vetëm Manchester City ka luksin të mendojë për titullin në këtë moment, ne të tjerët duhet të shohim dhe të sigurojmë sa më shpejt një nga katër vendet e para në Ligën Premier. Këtu përfshihet edhe Liverpooli, sa më shpejt ta sigurosh pjesëmarrjen në Ligën e Kampionëve, aq më shumë mundësi ke edhe për të ecur në garën e titullit", ka thënë Klopp. "Nuk e di nëse skuadra ime do të jetë në atë pozicion. Na duhet të grumbullojmë shumë pikë, edhe



pse një klub si Liverpooli e ka detyrim të jetë në garë dhe mes favoritëve për tituj. Për momentin nuk mendoj për kampionatin. Duhet ta përfundojmë në mënyrën e duhur fazën

përgatitore. Për mua e rëndësishme është ta krijoj harmoninë e duhur në skuadër, pasi aty është baza për një sezon pozitiv. Nëse ia dalim, mund të bëjmë mirë në garën e Premier Ligës", ka shtuar Kloppi.

SHKURT

Buffoni pensionohet në moshën 45 vjeçe

Gianluigi Buffon ka vendosur të largohet nga futbolli. Lajmi është dhënë nga mediet italiane, për t'u përhapur më pas në të gjithë botën. 45-vjeçari do ta ndërpresë kontratën me Parmën, e cila duhej të zgjaste deri në qershor 2024. Ai refuzoi një ofertë fitimprurëse në Ligën Pro të Arabisë Saudite, duke pëlqyer ta përfundojë karrierën e tij futbollistike. Buffoni mban rekordin e të gjitha kohëve për numrin e ndeshjeve të luajtura, plot 176, pasi bëri debutimin e tij në "play-off" të Kupës së Botës në tetor 1997 në moshën 19 vjeçe. I konsideruar gjerësisht si portieri më i mirë i të gjitha kohëve, "gardiani" i njohur fitoi Kupën e Botës 2006 me Italinë dhe është paraqitur në pesë edicione të ndryshme të Kupës së Botës. Ai fitoi 10 tituj kampionati, ose 12 nëse marrim parasysh dy të hequrit për skandalin Calciopoli. Buffoni ka luajtur për Juventusin, PSG-në dhe Parmën.

Xavi e pranon: Nuk mund të garojmë me PSG-në për Dembelen

Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, ka konfirmuar se janë të dorëzuar për çështjen e Ousmane Dembeles. "Ousmane Dembele na ka njoftuar se dëshiron të largohet te PSG-ja. Nuk mund të garojmë me PSG-në. Oferta e saj është shumë e lartë. Ai gjithashtu ka folur me Luis Enriquen dhe Al Khelaifin. Më dhemb sepse jemi kujdesur për të që ai të ndihet i lumtur këtu, por nuk mund të garojmë për të. Ai do të largohet", ka thënë Xavi. 26-vjeçari ishte transferuar te Barcelona në vitin 2017 për 135 milionë euro nga Borussia Dortmundi.

Mane, lojtar i Al Nasrit

Al Nasri ka bërë një tjetër goditje të madhe në merkaton e verës, duke afruar në skuadër Sadio Manen. Mesfushori është transferuar në Arabinë Saudite nga Bayern Munich, skuadër me të cilën arriti ta fitonte titullin kampion, megjithëse gjërat mes tyre nuk shkuan në mënyrën më të mirë të mundshme. Ndërkohë, klubi arab e ka paraqitur mesfushorin në një mënyrë mjaft të veçantë. Nëpërmjet një videoje, ata i kanë dedikuar një këngë teksa emri i Manes thirret nga të gjithë tifozët në kor. Al Nasri bën në këtë mënyrë goditjen e dytë të madhe në merkaton e verës për këtë sezon. Pak javë më parë klubi ku aktivizohet edhe Cristiano Ronaldo ka paraqitur Marcelo Brozoviçin.

PSG-ja fshin Mbappen edhe nga faqja zyrtare

"Luftë" totale ndërmjet Kylian Mbappes dhe PSG-së. Klubi francez po bën gjithçka që Mbappe të largohet nga Parisi. Fillimisht nuk e grumbulluan për fazën përgatitore, ndërsa së fundmi e kanë fshirë edhe nga faqja zyrtare e klubit. Kjo është lëvizja e radhës brenda pak ditësh duke konfirmuar qartë vullnetin e klubit: Mbappe nuk bën pjesë në planet e së ardhmes. Palët kanë arritur në atë pikë sa tani kërcënojnë njëri-tjetrin me padi. Kujtojmë që Mbappe ka një kontratë deri më 2024, pasi klauzola për të rinovuar edhe për një tjetër vit ra poshtë më 1 gusht.

Marcelo i thyen këmbën kundërshtarit, shpërthen në lot

Ndeshja e Kupës së Libertadores mes Argentinos Juniors dhe Fluminense nuk ka shkuar në mënyrën më të mirë të mundshme për ish-mbrojtësin

e Realit të Madridit, Marcelo. Futbollisti brazilian u bë protagonist në një lëndim të rëndë që i shkaktoi kundërshtarit. Në minutën e 57

të takimit, Marcelo bëri një ndërhyrje shumë të rëndë ndaj Sanchezit, duke i thyer këmbën. Menjëherë pasi e shkeli, Marcelo e kuptoi lëndimi që i ka

shkaktuar duke kërkuar edhe që të ndalet loja për t'i ardhur në ndihmë futbollistit kundërshtar. Pasi pa këmbën e kundërshtarit, Marcelo ka shpërthyer në lot

dhe me kartonin e kuq nuk ka pasur asnjë kontestim. Në fakt, duket qartë edhe nga pamjet se ndërhyrja e Marcelos është e paqëllimshme.

Në përputhje me Nenin 147 të Ligjit Nr. 06/L – 016 Për Shoqëritë Tregtare (“**LSHT**”) dhe me Statutin e saj, Shoqëria Tregtare “**GreenEnergyCenter**” L.L.C. e themeluar dhe regjistruar sipas legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë dhe e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (“**ARBK**”) me numër unik të identifikimit (“**NUJ**”) 811943308, duke vepruar përmes aksionarëve të saj, sot me datën 01 Gusht 2023 nxjerr këtë:

NJOFTIM**PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË**

- Kapitali i Shoqërisë zvogëlohet nga vlera e regjistruar prej 3,000.000.00 EUR (tre milion euro) në 2,500.00 EUR (dy mijë e pesëqind euro).
- Me zvogëlimin e Kapitalit të Shoqërisë, nga 300,000.00 Aksione me vlerë nominale prej 10 EUR secila, Shoqëria do të ketë 250 Aksione me vlerë nominale prej 10 EUR secila.
- Të gjithë Kreditorët eventual të Shoqërisë kanë të drejtën që në periudhën kohore prej 21 (njëzet e një) ditësh kalendarike, nga dita e publikimit të këtij Njoftimi në shtypin ditor, t'i drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose kërkesë për mos-zvogëlim të Kapitalit të Shoqërisë.
- Kërkesat i drejtohen Shoqërisë përmes postës së rregullt në adresën zyrtare si në vijim:
 - Rr. Xhavit Ahmeti, Nr. 128 – Prishtinë
- Kjo shpallje vlen për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike.

Pursuant to article 147 of the Law No. 06/L – 016 For Business organizations (“**LBO**”) and its Charter, the Business Organization “**GreenEnergy Center**” L.L.C. established in accordance with applicable legislation in Kosovo and registered in Kosovo Business Registration Agency (“**KBRA**”) with unique identification number (“**NUJ**”) 811943308, acting through its shareholders, today on 01 August 2023, issues the following:

NOTIFICATION**FOR DECREASE OF THE CAPITAL IN THE COMPANY**

- The Company's capital is decreased from the registered amount of 3,000,000.00 EUR (three million euros) into 2,500.00 EUR (two thousand and five hundred euros)
- With the decrease of the Company's Capital, from 300,000.00 shares with a nominal value of 10.00 each, the Company will have 250 Shares with a nominal value of 10.00 EUR each.
- All eventual Creditors of the Company within a period of 21 (twenty one) calendar days from the day of publication of this Notice in the daily press, have the right submit in the Company a request for additional security or a request for non-decrease of the Company's Capital.
- Requests should be addressed to the Company through the regular mail at the following official address:
 - Str. Xhavit Ahmeti, No. 128 – Pristina
- This announcement is valid for a period of 30 calendar days.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “**KRRATO**” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. UNIK: 810038621 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da društvo sa “**KRRATO**” D.O.O. od Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nr. 810038621 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “**KRRATO**” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 810038621 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Njoftim për zvogëlim kapitali

Pronarët e biznesit “**JARA HOME**” SHPK, magjistrerja MITROVICË me numër unik identifikues: 811359282, z. VALON FEJZULLAHU vendosi që të bëjë zvogëlimin e kapitalit vlera e regjistruar 300 mijë euro në kapitalin 10 mijë euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Marigona Hyseni shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme “Ymer Prizreni “ Prizren.

- Rina Rama shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi “ Prizren.

- Arif Mustafi shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi “ Prizren.

- Rafet Islamaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV dhe diplomën QK “11 Marsi “ Prizren.

- Leotrim Zeqiraj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Bajram Curi “ Krushe e Madhe.

- Afrim Vehapi B.I. DPZ “ONIKS-1” shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, për import-export, me numër unik të biznesit: 810345654.

- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër “Bill Clintonit”, kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra “Qerimi2”, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshepte



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
(Award in alphabetical order)

- ★ NRC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fábrica de Bebidas Gasosas Salvadoreñas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Firdi S.p.ka. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Fuzaris Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Králové Československo s.r.o. Czech Republic, Quality
- ★ Ibi Zotal CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Pariza Sales soken Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales